



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTESISË

DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE « ENFORCEMENT GROUP » SHPK

Adresa; Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall, e Shoqerise "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane Tel:

0692087566

e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com




Nr.1073/4 Prot.

Nr.1205 Regj.

Tirane me 31.07.2017

**URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS MBI AKSIONET E DEBITORIT**



Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit / Tirane
Per dijani: Shoqëria SBM Processing shpk
Administratorët Roman Bernard dtl 17.08.1964 dhe Gani Hoxha dtl 29.05.1963
Adresa : Rr. "Karl Gega" pall.3/1 Ap.11, Tiranë
Për dijani: Ortakët Shoqëria Flycom d.o.o dhe Shoqëria SBM Grup shpk
Adresa: Rr. "Karl Gega" pall.3/1 Ap.11, Tiranë

Une Altin Latifi, me detyre Permbarues Gjyqesor Privat prane Shoqërisë Permbarimore "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes Nr.1205 Regj, bazuar ne Vendimin Gjyqesor Për Marrjen e masës së Sigurimit, Nr. 846 Akti, dt.26.07.2017 i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë,

K O N S T A T O V A

Se ne date 31.07.2017, prane Shoqërisë Përmbarimore "Enforcement Group" shpk është depozituar për ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria Vagalat shpk, se bashku me titullin ekzekutiv Vendimin Gjyqesor Për Marrjen e masës së Sigurimit, Nr. 846 Akti, dt.26.07.2017 i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, me pale e objekt :

-Kreditor: Shoqëria Vagalat shpk
-Debitor: Shoqëria SBM Processing shpk me Nipt L17710901V
Flycom d.o.o me numër tatimor SI 10286314
SBM Grup shpk Nipt L08218901B
Romand Bernard i dtl.17.08.1964
Gani Selman Hoxha i dtl.29.05.1963
-Objekti: Sigurim Padie

Me anë të këtij titulli ekzekutiv, ndër të tjera, Gjykata ka vendosur Sigurimin e padisë, duke vendosur sekuestro mbi kuotat e Shoqëria SBM Processing shpk me Nipt L17710901V dhe mbi kuotat e ortakëve të saj Shoqëria Flycom d.o.o me numër tatimor SI 10286314 dhe Shoqëria SBM Grup shpk Nipt L08218901B, duke urdhëruar Qendrën Kombëtare të Regjistrimit që të mos tjetërsojë këto kuota deri në shumën 20,000,000 (njëzet milion) lekë.

Per sa me sipër: Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative deri në shumën 20,000,000 lekë në kuotat e debitorëve:
a-Shoqëria SBM Processing shpk me Nipt L17710901V
b-Shoqëria Flycom d.o.o me numër tatimor SI 10286314
c-SBM Grup shpk Nipt L08218901B.
- 2.Kuotat e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri momentin e revokimit të masës së sigurimit të padisë.
- 3.Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4.Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdheri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne nenin 606 te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
- 5.Pas dergeses se ketij urdheri per vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit te sipercituar ne shoqerine e sipercituar, kerkojme te na dergohet prane zyres sone statusi i aksioneve pas kryerjes se bllokimit, brenda afatit ligjor.

Bashkangjitur Ju dërgojmë një kopje të vendimit Për Marrjen e masës së Sigurimit, Nr. 846 Akti, dt.26.07.2017 i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.

SHOQERIA PERMBARIMORE "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALTIN LATIFI




The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular blue stamp. The stamp contains the text "SHOQERIA PERMBARIMORE 'ENFORCEMENT GROUP' SHPK" around the perimeter and "PËRMBARUESI GJYQËSOR ALTIN LATIFI" in the center. The signature is written over the stamp, partially obscuring it.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE



Nr.846 Akti
Dt.05.07.2017 Regj

Dt.26.07..2017


“ PER SIGURIMIN E PADISE ”
Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane perbere prej,
Agron **ZHUKRI GJYQATAR**

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Eranda HYSI**, sot me dt. **26.07.2017**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me pale:

Kerkues: Shoqëria “VAGALAT” sh.p.k e regjistruar prane QKR, Si person ridik, e identifikuar me NIPT J691025031, me administrator Z. Sefer Hoxha, përfaqësuar me autorizimin e dates 16.01.2015 nga Studio Ligjore "H & A Law Firm" sh.p.k., regjistruar në QKR Tiranë me NIPT L323190151, me administrator Av. Idajet Celaj, me licence nr. 1329, me adrese Adresa Blv. "Gjergj Fishta", Projekt 2000, Kulla 5, Kati 2, Ap. 6, Tirane. Perfaqesuar ne gjykim nga Av; Aldora Koka dhe Andi Skenderi me autorizim dt. 12.07.2017.

Person i trete: Shoqeria SBM Processing sh.p.k, perfaqesuar nga Mikel Gjika dhe Av; Dalip Bushi.

Objekti: Marrjen e mases se sigurimit te padise duke vendosur sekuestro konservative mbi llogarite bankare te shoqerise Shoqerise "SBM Processing"sh.p.k, me NIPT L17710901V, perfaqesuar nga administrator Z. Gani Hoxha, ne te gjitha bankat e nivelit te dyte si dhe sekuestro konservative ne cdo aset tjetër financiar, sende te luajtshme dhe te paluajtshme ne emer te shoqerise, administratorit dhe/ apo ortakeve te saj; ne shumen 40.928.977 Leke si detyrim kontraktual, me qellim garantimin e pagimit te detyrimit deri ne zgjidhjen perfundimtare te ceshtjes.

Baza Ligjore: Neni 202/a, 203, 204, 206/a te K.Pr.Civile

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e kerkuesit per sigurimin e padise, prapësimet e personit te trete dhe si çmoi provat e administruara deri ne kete fazë të hetimit gjyqesor në raport me elementet procedural civil të sigurimit te objektit të padisë;

VEREN

Pranë Gjykates së Rrethit Gjyqesor Tiranë Shoqëria “VAGALAT” sh.p.k, ka paraqitur kërkesa për marrjen e masës së sigurimit.

Nga analiza e provave te paraqitura nga palet ndergjyqese deri ne fazen aktuale te hetimit gjyqesor rezulton e provuar se :

Shoqeria "VAGALAT" sh.p.k e regjistruar prane QKR, Si person juridik, e identifikuar me NIPT J691025031, me adrese: Lagjia Mustafa Matohiti, Godine 3-kateshe, Kati Perdhite Tepelene, me perfaqesues ligjor Z. Sefer Hoxha, ka si objekt te aktivitetit te saj "Ndertime civile dhe ekonomike, ujesjellesa dhe kanalizime, ndertim rruges, punime topografike. Projektim bazprnenteve gjeodezike per rilevime ne te gjitha shkallet, punime dheu dhe sistemime, taracime terrenesh. Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertim ujesjellesa kanalizime. Ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese. Punime mbrojtjeje dhe sistemimin hidraulike, sillosa, kulla, kulla uji etj prej beton armeje, irietalike. Rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash etj. Punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, aktivitet tregrare, importeksport te materialeve te ndertimit dhe pajisjeve te nderrimit te veglave te punes per aktivitetin ndertues." Midis shoqerive Shoqeria "VAGALAT" sh.p.k dhe shoqerise "SBM Processing" sh.p.k, me NIPT L17710901V ekzistojne disa marredhenie kontraktuale ne baze te se ciles shoqeria "Vagalat" sh.p.k ka kryer sherbimet e transportit dhe te furnizimit ne baze te termave dhe kushteve te marrreshjeve te "Moratorium i Marreveshjes" lidhur mes paleve.

Si rezultat i ketyre marredhenieve, Shoqeria "VAGALAT" sh.p.k, ka kryer te gjitha sherbimet teknike dhe detyrimet e saj kontraktuale sipas objektit te kontrates dhe afateve te percaktuara nga palet, dhe bazuar ne faturat perkatese, shoqeria "SBM Processing" sh.p.k, duhet te kryente pagesa brenda nje periudhe 30 (tridhjete) ditesh nga dita e miratimit te deklarates mujore te punimeve me date 5 te cdo muaji, sipas percaktimeve te nenit 12 te "Moratorium i Marreveshjes".

Rezulton nga aktet provuese bashkangjitur kerkese se Shoqeria "VAGALAT" sh.p.k ka e permbushur detyrimin e saj kontraktor, pasi jane miratuar nga supervizori dhe nga shoqeria "SBM Processing" sh.p.k te gjitha deklaratat mujore te punimeve, duke kryer sherbimet sipas kontrates dhe duke i pajisur me fature tatimore per sherbimet e kryera, kurse shoqeria "SBM Processing" sh.p.k, nuk e ka permbushur detyrimin per kryerjen e pageses.

Nga kontaktet e herepashershme qe kane pasur perfaqesuesit e Shoqerise "VAGALAT" sh.p.k me shoqerine "SBM Processing" sh.p.k, eshte premtuar se shume shpejt do te kryenin pagesen, por nderkohe kane kaluar mbi 3 vjet nga sherbimi i fundit i kryer, per periudhen kohore 01.06.2013 - 29.06.2014, nuk eshte bere likujdimi i detyrimit kontraktual i cili ne baze ekspertimit kontabel rezulton ne nje vlere te konsiderueshme kjo e provuar.

Rezulton se mospagimi ne kohe, jo vetem i ka shkaktuar dem financiar Shoqerise "VAGALAT" sh.p.k, por e ka vendosur ate ne veshtiresi financiare perballe furnizuesve te saj kryesor.

Me ane te njoftimit qe prej dates 10.04.2015, kerkuesi i eshte drejtuar pales debitore shoqerise "SBM Processing" sh.p.k, per shlyerjen vullnetare te detyrimit te palikujduar. Me ane te shkreses Nr. 19 Prot., date 15.04.2015 te shoqerise "SBM Processing" sh.p.k, palet kane kerkuar caktimin e nje takimi per rakordim, por pavaresisht kerkimeve shkresore te pales debitore, nga ana e tyre eshte shtyre pambarimisht takimi, faktuar me ane te korrespondences mes paleve dhe me pas nuk u realizua asnjehere.

Rezulton e provuar se pala debitore "SBM Processing" sh.p.k, nepermjet shkresave te saj drejtuar shoqerise "Vagalat" sh.p.k, ka pranuar detyrimin monetare ndaj shoqerise Vagalat dhe konteston nje pjese te saj.

Pala kerkuese kerkon sigurimin e padise pasi:

Duke qene se gjendemi perpara mos permbushjes te detyrimeve kontraktuale dhe atyre furnitore, nisur nga veprimet konkludente te pales se paditur ne kete gjykim, mosrespektimi i

mardhenies kontraktore e ka ngarkuar me kosto te renda financiare palen kerkuese, te cilat kane sjelle deme te madha ekonomike, te cilat jane provuar edhe nga ekspertet ne baze te pyetjeve drejtuar nga pala paditese ne kete gjykim te cilat kapin vlera shume te larta. Duke qene se gjendemi perpara mospermbushjes te detyrimeve kontraktore qe burojne nga nje kontrate ekskluzive, fakt i cili eshte provuar nepermjet faturave tatimore te shitjes librave te blerjes dhe shitjes, kontratave me te trete ne ralizim te projekteve dhe gjithashtu me korrespondeca mes palesh provohet se shoqenia "SBM Processing" sh.p.k, eshte shoqeri debitore. Kjo eshte arsyeja qe kerkuesi eshte detyruar t'i drejtohet Gjykates Rrethit Gjyqesor Tiranë, me kete kerkese per sigurimin e padise, duke i kerkuar kesaj gjykate sekuestro konservative mbi llogarite bankare te debitorit si dhe sekuestro konservative mbi cdo pasuri (send te luajtshem dhe te paluajtshem) ne emër te shoqerise si dhe aksioneve te saj, per shumen e debise si detyrim kontraktual me qellim garantimin e pagimit te detyrimit deri ne zgjidhjen perfundimtare te ceshtjes ne menyre qe vendimi i gjykates ne rastin e pranimit te padise te jete nje vendim i ekzekutueshem dhe konkret ne garantimin e te drejtave te pales kreditore pasi ne eventualitet te pranimit te padise ateher ekzekutimit i detyrimit do te ishte i pamundur ose shume i veshtire pasi ky eshte dhe kuptimi i vertete i vendosjes se mases se sigurimit te padise aq me teper qe ne kete gjykim eshte provuar se dem ndaj shoqerise eshte i madh ne vlere financiare te atille qe e ben akoma edhe me te nevojshme marrjen e kesaj mase per te garantuar te drejten e provuar te paditesit ne kete gjykim.

Kesisoj, ne kushtet kur ky gjykim ka mbi dy vite qe eshte duke u gjykuar edhe per shkak rrethanash objektive dhe per sa kohe nga ana e shoqerise "SBM Processing" sh.p.k, nuk eshte lene mundesi tjeter per zgjidhje.

Nga mospermbushja e detyrimit shoqerise i ka ardhur dem i rendë edhe pse ky dem eshte efektiv, pasojat e se ciles jane te pariparueshme dhe te pajustificura ne veprimtarine normale te saj. Ky dem po i vjen shoqerise "Vagalat" sh.p.k nga mospermbushja e detyrimit kontraktual prej pales shiteses blerese duke u bere ai shkaktari i veshtiresive per shkak te prishjes ne menyre te njehshme te kesaj marredhenie. Nje gjendje e tille e shoqeruar me tejzgjatje te gjykimit te ceshtjes, jo vetem per shkak te vetë natyres se konfliktit por dhe per faktin se ne kushtet e krizes financiare si dhe gjykimit ne tre shkalle te ceshtjes objekt gjykimi, do te çojte ne menyre te pashmangshme ne probleme shume serioze veprimtarine e shoqerise kerkuese, duke sjelle per rrjedhojë cenimin e marredhenieve financiare me partneret, banka, dhe aktore te tregut.

Marrja e mases se "Sekuestros konservative" per bllokimin e te gjitha llogarive dhe e asetave te cfaredo forme, te luajtshme apo te paluajtshme te debitorit nga ana e gjykates, do te sherbeje per te garantuar ekzekutimin e detyrimit pasi tejzgjatja e gjykimit te ceshtjes, mund te perkeqesoje gjendjen financiare si dhe te perkeqesoje mardhenien e shoqerise Vagalat sh.p.k, duke e bere me pas ekzekutimin e ketij vendimi te veshtire ose te pamundur. Gjithashtu marrja e kesaj mase do te sherbeje edhe per te mos e lejuar shoqetine "SBM Processing" sh.p.k, te transferoje tek te tretet te gjitha likuiditetet qe disponon apo edhe sendet aset te saj e te mund te ndermarre veprime tjetersimi duke i kaluar pasurite e saj ne emër te te treteve. Ky tjetersim, do ishkaktonte nje dem akoma edhe me te rende dhe te parikuperueshme dhe njekohesisht do te linte ceshtjen pa objekt gjykimi.

Referuar praktikës permbarimore te shoqerise Enforcement Group vene ne levizje nepermjet kreditorit "Vagalat" sh.p.k me debitor "SBM Processing" sh.p.k, per sa i perket ekzekutimit te Urdherit te ekzekutimit Nr. 3591 Akti, date 01.06.2015 i gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ka rezultuar se pala e paditur ne kete gjykim i ka shitur te gjitha asetet e saj. Fakt ky qe provohet me shkresen nr. 2039/1 Prot., date 07.04.2017te DPSHTRR, rezulton se nuk ka mjete ne pronesi ky subjekt, ndryshe nga sa rezulton nga ekstrakti historik i QKR ne te cilin listohen nje sere mjetesish si aset te subjektit.- Referuar proces-verbalit te konstatimit

te permbarduesit date 18.04.2017, nga ana e "SBM Procesing" me ane te kontrates noteriale date 21.10.2015, eshte shitur e gjithë baza materiale qe konsistonte ne makineri dhe aksesore per perpunimin e ferrokromit, baza e aktivitetit te te paditurit.- Referuar po shkreses se DRT Diber date 15.05.2017, ky subjekt ka per te marre nga kjo drejtori(DRT Diber) nje vlete te konsiderueshme si rimbursim te TVSH-se, per te cilen eshte ne proces gjyqesor me DR prane Gjykates Adm Tirane.

Pavaresisht se nga ana e permbarduesit ne ekzekutim te dosjes se sipercituar eshte kerkuar nga QKB venia e sekuestros mbi kuotat e debitorit dhe moslejimi i kryerjes se veprimeve ne QKR per kete subjekt, SBM Processing ka pezulluar fillimisht aktivitetin ne QKR.

Ne mungese te kryerjes se aktivitetit vazhdues dhe te tjetersimit te asetëve te luajtshme dhe te paluajtshme, vendimi i kesaj gjykate mbetet i paekzekutueshem. Mosekzekutimi i qellimshem i kontrates nga debitori është prove e cila vërteton se ata jane jokorrektë dhe të pabesushem duke provuar njëkohësisht rrezikun real të tjetërsimit të pasurive të tyre ndërkohë që mospermbushja e detyrimit nga debitori e ka çuar shoqërine kerkuese te kete probleme apo dhe banka dhe rrjedhimisht duke i cuar ne vështirësi ekonomike si dhe duke i prishur figuren kesaj shoqerie perballe aktoreve te rendesishern te tregut si dhe duke ulur besimin e shoqerise ne projekte te tjera.

Qellimi i mases së sigurimit është ngrirja e situates në gjëndjen e tyre fillestare të konfliktit per t'i mundësuar Gjykates që në përfundim te gjykimit, vendimi i saj të kete mundesi te rivendosjes te se drejtave te seciles prej paleve.

Personi i trete: kerkoi rrezimin e kerkeses per sigurimin e objektit te padise duke pretenduar se lidhur me kerkimet pala ka ngritur padine e themelit pasi ka dhe vendime te tjera gjyqesore qe keto fatura jane zhvlefesuar dhe duke qene se eshte ngritur padia e themelit te provojne njehere detyrimin pastaj te bejne keto kerkime.

Nese gjykata e vendos detyrimin p.trete ishte dakort te njohe si detyrim dhe pohoi se nuk i shmanget. Kur te provohet gjyqesisht shuma e detyrimit atehere pala paditese mund te beje keto kerkime, ne kushtet kur detyrimi kontestohet nuk mund te behen keto kerkime aktiviteti tregtar nuk eshte i kushtezuar nga ky kerkim pasi vetem shteti i ka si borxh per t'i paguar nje shume me te madhe se kerkimi.

Aktiviteti i p.trete nuk eshte keshtu sic e tregon pala kerkuese, pasi disponojne shume firma qe punojme ajo eshte nje kontrate qe eshte bere me nje firme dhe aktiviteti i p.trete eshte i pasqyruar dhe ne ekstrakt.P.trete kerkoi te mos pezullohet aktiviteti, pasi jane gati te paguajne. Duke permendur se kane dhe dy kontrata me shoqeri greke qe tregon qe se kane aktivitet dhe me firma te tjera.

Gjykata pasi mori ne shqyrtim kerkimin e pales kerkuese per marrjen e mases se sigurimit te padise, prapesimet e pales se paditur ne lidhje me kete kerkese dhe si cmoi provat e administruara ne gjykim në drejtim të elementeve procedurale civile mbi sigurimin e padisë vendos pranimin e pjesshëm të kërkesës së palës paditëse.

Neni 202 i Kodit te Procedures Civile sanksionon :

" Me kerkesen e paditesit gjykata brenda 5 diteve lejon marrjen e masave per sigurimin e padise kur ka arsye te dyshohet se ekzekutimi i vendimit per te drejtat e paditesit do te behet i pamundur ose i veshtire. Sigurimi i padise lejohet kur : a) padia mbeshetet ne prova me shkrese b) paditesi jep garanci ne llojin dhe masen e percaktuar nga gjykata per demin qe mund ti shkaktohet te paditurit nga sigurimi i padise. Garancia mund te kerkohet dhe per rastin e parashikuar nga shikronja a e ketij neni ".

Neni 203 i Kodit te Procedures Civile parashikon :

" Sigurimi i padise lejohet per te gjitha llojet e padive dhe ne cdo faze gjykimi, derisa vendimi te marr forme te prere".

Ne nenin 206 te Kodit te Procedures Civile percaktohet :

"Sigurimi i padise behet : a) me sekuestrimin e sendeve te luajtshme, te paluajtshme si dhe te kredive te debitorit b) me marrjen nga ana e gjykates te masave te tjera te pershtatshme duke perfshire pezullimin e ekzekutimit. Gjykata mund te lejoje sigurimin e padise me disa nga llojet e ndryshme te masave te sigurimit , por gjithmone per nje shume te pergjithshme jo me te madhe se ate te padise".

Sigurimi i objektit te padise konsiderohet mjet procedural per garantimin e ekzekutimit te ardhshem te drejtave te paditesit, ne rast te njohjes apo rivendosjes se tyre gjyqesisht ne perfundim te gjykimit te mosmarreveshjes civile me te paditurin.

Objekti i padise mund te sigurohet vetem ne kushtet kur paditesi, i cili pretendon se eshte mbajtes i nje te drejte, ka arsye te bazuara per te dyshuar se do te gjendet ne veshtiresi apo pamundesi per te realizuar te drejtat e percaktuara nga nje vendim i ardhshem gjyqesor qe mund te pranoje kerkimet e tij ndaj te paditurit. Ne kete kontekst vleresimi gjyqesor i mundesise se sigurimit te objektit te padise duhet te mbeshtetet ne analizen e provave shkresore te cilat :

1. provojne fakte juridike ne lidhje me marredhenien objekt konflikti mes paleve. Ne kete rast gjykata perjashton cmimin dhe cilesimin e provave ne drejtim te themelit te mosmarreveshjes, duke u kufizuar ne krijimin e perceptimit te pergjithshem ne raport me kerkimet e prapesimet e paleve ne funksion te sigurimit te objektit te padise

2. mundesojne vleresimin nga gjykata te ekzistences se rrezikut te pamundesise apo veshtiresise se ekzekutimit te ardhshem te drejtave te paditesit. Pasiguria ekzekutive e vendimit te ardhshem gjyqesor buron nga rreziku qe i padituri me veprimet e tij te pengoje apo te veshtiresoje rivendosjen e drejtave te gjyqfituesit nese nuk merren masat e perkohshme dhe te nevojshme per te parandaluar nje situat te tille juridike.

Sigurimi i padise eshte gjithmone i ndervarur nga kerkimi i themelit te paditesit, pasi individualizimi i mases nga gjykata synon te siguroje te drejten e pretenduar. Per kete shkak paditesi krahas sigurimit te padise duhet te percaktoje saktesisht dhe kerkimin e padise se themelit, e cila duhet te kete nje objekt te percaktuar ose te percaktueshem ne menyre qe masa e vendosur nga gjykata te te siguroje te drejten objekt kerkimi dhe te mos tejkaloje masen e saj.

Nga analiza e provave te administruara deri ne fazen aktuale te hetimit gjyqesor rezulton te permbushen te gjitha kriteret determinante procedurale qe diktojne nevojten e sigurimit te padise, por vetem persa i perket.

Kerkimi i paditesit per marrjen e mases se sigurimit te padise mbeshteten ne nje sere provash shkresore mbi te cilat pretendohet te provohet bazueshmeria e ligjshmeria e kerkimit civile mbi permbushjen e detyrimit kontraktor.

Gjate hetimit gjyqesor jane paraqitur nga pala paditese dhe jane administruar ne cilesine e provave Urdher pe venie sekuestro, Kthim pergjigje dt. 16.05.2017, nga DRT Diber, Kontrata e shitblerjes se sendeve te luajtshme dt. 21.10.2015, Proces-verbal , Kerkese dt. 05.04.2017, Urdher sekuestro konservative dt. 04.04.2017, Kthim pergjigje, Sekuestro dt. 04.04.2017, Kthim pergjigje dt. 06.06.2017 te DPTatimeve, Kthim pergjigje dt. 07.04.2017, Shkrese dt. 03.04.2017, Rifillim procedure permbarimore dt 15.03.2017, Kthim pergjigje DRDiber dt 15.05.2017, Vendim per pezullim te 02.07.2015, Percjellje per kompetence dt.

10.07.2015, Kerkese per informacion dt. 26.06.2015, Lajmerim per ekzekutim vullnetar dt.26.06.2015.

Keto prova, qe padyshim nuk mund t'i nenshtrohen ne kete arsyetim analizes se fakteve dhe fuqise provuese ne raport me themelin e konfliktit gjyqesor, perbejne inidicie te mjaftueshme mbi ekzistencen e marredhenies juridike mes paleve apo te drejtes se pretenduar, por ende te pavartetuar perfundimisht te pales paditese. Ky fakt nenkupton se sigurimi i objektit te padise nuk lidhet me nje kerkim civil te hamendesuar nga paditesat, por te bazuar ne prova fillestare, vleresimi i te cilave do ti perkase perfundimit te gjykimit dhe vendimmarrjes gjyqesore ne raport me mosmarreshjen mes paleve.

Sigurimi i objektit te padise cmohet nga gjykata si nje mase emergjente dhe e domosdoshme per te shmangur cdo suate juridike qe ne te ardhmen mund te beje te veshtire ose te pamundur ekzekutimin e te drejtes objekt gjykimi ne rast se cmohen te bazuara kerkimet e paditesit ndaj pales se paditur.

Ne themel te padise qendron nje kerkim me natyre kontraktore qe buron nga marredhenia juridike e lindur mes paleve, ku i padituri ne pozitat e debitorit pretendohet te jene ne vonese ne shlyerjen e detyrimit të lindur nga shërbimi i ofruar nga pala paditëse. Ne rast te pranimit te ardhshem te padise, si nje alternative e mundeshme procedurale, paditesi gjyqfitues mund te ekspozohet ndaj riskut te veshtiresise apo pamundesise se ekzekutimit te vendimit gjyqesor nese nuk merren paraprakisht masat e nevojshme per te siguruar mostjetersimin e pasurise se pales debitore, e cila mund t'i nenshtrohet ekzekutimit per llogari te kredise se gjyqfituesit. Mbajtja perkohesisht " e ngrire " e gjendjes juridike te pronesise mbi pasurite e pales debitore permes vendosjes se sekuestros për bankat e nivelit të dytë perben nje garanci per gjyqfituesin se e drejta e fituar permes procesit gjyqesor mund te perfitohet efektivisht ne fazen e ekzekutimit.

Ne te kunderten e ketij konkluzioni mosveprimi i gjykates per sigurimin e te drejtes objekt gjykimi do te ekspozonte paditesin ndaj suate se mosgjetjes se pasurive te debitorit per shlyerjen e detyrimit per shkak te mundesise potenciale te tjetersimit te saj. Ky fakt do ta cilesonte jo efektive te drejten e fituar gjyqesisht ne kushtet e pamundesise se ekzekutimit te saj, si pjese e vijimesise se nje procesi te rregullt ligjor.

Ky rrezik behet me evident duke marre ne konsiderate faktin se i padituri ndodhet prej disa vitesh ne pamundesi te pagimit te detyrimit te mbetur, për më tepër që kryerja e veprimeve të tilla si krijimi i një shoqërie tjetër nga ana e tyre apo shitja e te gjitha asetete mund të vështirësonte këtë shlyerje, prandaj mosmartja e masave per bllokimin e llogarive bankare mund te thelloje gjendjen e tyre te insolvabilitetit.

Per te shmangur proceduralisht cdo suate juridike qe mund ta bente te pamundur ekzekutimin e vendimit te ardhshem gjyqesor ne rast se vleresohen te bazuara kerkimet e paditesave gjykata cmon se duhen marre masa te pershtatshme per sigurimin e objektit te padise, konkretisht Shoqerise "SBM Processing" sh.p.k, me NIPT L17710901V, perfaqesuar nga administrator Z. Gani Hoxha, ne te gjitha bankat e nivelit te dyte si dhe sekuestro konservative ne cdo aset tjetër financiar, sende te luajtshme dhe te paluajtshme ne emer te shoqerise, administratorit dhe/ apo ortakeve te saj, ne shumen 20.000.000 Leke. Persa i perket vleres se detyrimit per te cilen kerkohej vendosja e sekuestros, gjykata nuk e pranoi teresisht, por vetem vleren per te cilen edhe pala e paditur nuk kishte kontestime dhe se e pranonte si detyrim, ndersa per pjesen tjetër gjykata nuk krijoi bindjen per ekzistencen e ketij detyrimi ne kushte kur gjykimi i themelit ka te beje pikerisht me kontestimin e kesaj vlere dhe si te tille nuk e pranoi teresisht vleren per sigurimin e padise.

Ne kete konkluzion gjykata arriti duke patur ne konsiderate parashikimet e nenit 205 te K.Pr.Civile, ku ne paragrafin e pare te saj parashikohet shprehimisht se: "Sigurimi i padise

mund te lejohet per te gjithë padine ose vetem per nje pjese te saj, qe gjykata i gjen te bazuar, ne perputhje me rregullat e parashikuara...".

Në këtë aspekt gjykata thekson se një qëndrim i tillë është mbajtur dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues Nr. 10, datë 24.03.2004, ku përcaktohet se: "...Në radhë të parë gjykata duhet të vlerësojë nëse masa e përkohëshme për sigurimin e padisë e kërkuar nga paditësi është në përshtatje me kërkesat e nenit 202 të KPrCivile, në veçanti nëse ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit eventual për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë".

Përsa i përket llojit të masës së sigurimit të objektit të padisë, Gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatëshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit. Në këto raste marrja e masave të përkohëshme të sigurimit të padisë synon "ta mbajë gjëndjen ashtu sic është", apo "të ngrirë", deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithësesi, që të respektohet një standart i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, gjykata vlerëson se është e nevojshme Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative mbi llogaritë bankare të shoqërisë Shoqërisë "SBM Processing" shpk, me NIPT L17710901V, perfaqesuar nga administrator Z. Gani Hoxha, në të gjitha bankat e nivelit të dytë si dhe sekuestro konservative në çdo aset tjetër financiar, sende të luajtshme dhe të paluajtshme në emer të shoqërisë, administratorit dhe/ apo ortakeve të saj, në Shumen 20.000.000 Leke si detyrim kontraktual, me qëllim garantimin e pagimit të detyrimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes

PER KETO ARSYE

Ne baze të neneve 202, 203 dhe 206 të KPrCivile

VENDOSI

- Pranimin pjesërisht të kërkesës
- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative mbi llogaritë bankare të shoqërisë Shoqërisë "SBM Processing" shpk, me NIPT L17710901V, perfaqesuar nga administrator Z. Gani Hoxha, në të gjitha bankat e nivelit të dytë si dhe sekuestro konservative në çdo aset tjetër financiar, sende të luajtshme dhe të paluajtshme në emer të shoqërisë, administratorit dhe/ apo ortakeve të saj, në Shumen 20.000.000 Leke si detyrim kontraktual, me qëllim garantimin e pagimit të detyrimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
- Shpenzimet gjyqësore sic janë bere.
- Kunder këtij vendimi lejohet ankimi i vecante në Gjykatën e Apelit Tirane.
- U shpall në Tirane sot me 26.07.2017.

SEKRETARE
ERANDA HYSI

